

Z. Kelment Greca ka fituar titullin "Jurist" në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 2001. Më pas, ka vijuar studimet Master Profesional "Shërbim Prove" në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, në vitin 2016.

Z. Greca ka përvojë pune mbi 20 vite, ku nga këto ka mbi 11 vite përvojë pune në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe administratës publike.

Z. Greca ka kryer një sërë kualifikimesh dhe trajnime, nga institucione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, duke disponuar çertifikata dhe dëshmi të ndryshme trajnimi dhe kualifikimi, në fushën e drejtësisë, burimeve njerëzore, fondeve publike etj.

Zotëron gjuhën italiane dhe angleze.

Aktualisht, nga shkurti 2022 e në vijim, mban pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Z. Xhevdet Haxhiu, është diplomuar në Shkenca Ekonomike (dega financë), titulli Financier i Lartë, në vitin 1990.

Është çertifikuar me titullin "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", në vitin 2009.

Ka studimet Master në Menaxhim Mjedisor, mikroteza "Auditimi mjedisor, si mjet i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm", në vitin 2012.

Është licensuar me titullin "Ndërmjetësues" nga Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetsimit Tiranë, në vitin 2016.

Z. Haxhiu, ka kryer një sërë kualifikimesh dhe trajnime, nga institucione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, duke disponuar çertifikata dhe dëshmi të ndryshme trajnimi dhe kualifikimi, në fushën e menaxhimit, administrimit, programimit, zbatimit, monitorimit dhe auditimit, të fondeve buxhetore, pasurisë publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe ka pjesëmarrje në takime të ndryshme pune, brenda dhe jashtë vendit, si përfaqësues i institucioneve ku ka punuar.

Z. Haxhiu, ka një eksperiencë pune shumëvjeçare (mbi 30 vite) në administratën publike, duke mbajtur pozicione të ndryshme si llogaritar i parë, inspektor kontrolli, auditues dhe drejtor drejtorie, konkretisht në fushën e auditimit, menaxhimit, administrimit, programimit, zbatimit dhe monitorimit të fondeve buxhetore, pasurisë publike dhe të burimeve njerëzore, ku eksperiencën më të gjatë (27 vite) e ka në disa institucione të pavarura kushtetuese (Kontrolli i Lartë i Shtetit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor).

Nga dhjetori 1990 deri në maj 1992, në pozicionin Llogaritar i parë, nga shtatori 1992 deri në janar 2013 në pozicionin Inspektor kontrolli, Kontrollor dhe Auditues dhe nga janar 2013 deri në gusht 2023 në pozicionin Drejtor drejtorie.

Aktualisht, nga gushti 2023 e në vijim, mban pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Z. Henri Hatillari, ka mbaruar studimet e larta në degën Informatik, si dhe ka kryer Master Shkencor në “Inxhinieri Informatike”.

Z. Hatillari zotëron njohuri shumë të mira mbi rregullat, praktikat dhe procedurën e funksionimit të gjykatave, jo vetëm prej njohurive të kuadrit ligjor, që rregullon funksionimin e tyre, por dhe për shkak të përvojës që ka pasur si specialist IT për shumë vite, si dhe shef sektori në Sektorin e Suportit dhe Menaxhimit të Cështjeve.

Aktualisht, nga prilli 2023 e në vijim, mban pozicionin e Drejtorit të IT dhe Menaxhimit të Cështjeve, në Departamentin e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Blerta Ngucaj, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, në vitin 2010. Në vitin 2011 është pajisur me licensën e Avokatisë.

Nga dhjetori 2012 deri në korrik 2018, ka qenë e angazhuar si këshilltare ligjore në projektin “Ofrimi i Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e në Portofoli të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) në Republikën e Kosovës.

Gjthashtu, vlen të theksohet dhe angazhimi si eksperte ligjore në EULEX.

Nga maji 2014 deri më mars 2019, znj.Ngucaj ka qenë e angazhuar si avokate duke përfaqësuar klientë në cështje civile, administrative dhe penale, përgatitje dosjesh gjyqësore, draftim opinionesh ligjore për klientë kombëtar dhe ndërkombëtar, memoransumesh etj.

Nga marsi 2019 deri më qershor 2021 ka qenë e angazhuar si eksperte ligjore në projektin e financuar nga BE mbi konsolidimin e drejtësisë (EURALIUS V). Një projekt tjetër me rëndësi ka qenë pjesëmarrja në përgatitjen e hartës së re gjyqësore.

Gjatë angazhimit si eksperte e EURALIUS ka ofruar komente, rekomandime dhe sugjerime në formën e opinioneve ligjore në lidhje me aktet nënligjore të propozuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Vlen të përmendet se, znj.Ngucaj ka organizuar dhe ka qenë pjesë e workshopeve dhe trajnimeve për Gjykatën e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe tryezave të rrumbullakëta të OJF-ve etj.

Gjatë periudhës prill-dhjetor 2021 ka qenë e angazhuar si eksperte ligjore senior nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për draftimin e një raporti gjithëpërfshirës mbi aktivitetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me qëllim identifikimin e arritjeve dhe sfidave në punën e Këshillave, ofrimit të përfundimeve dhe rekomandimeve konkrete për këto organe.

Aktualisht, nga marsi 2023 e në vijim, mban pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Etrita Petriti, ka përfunduar studimet e larta në fushën e drejtësisë, konkretisht diplomë e nivelit DIND “Drejtësi”, Fakulteti i Drejtësisë “Luarasi” dhe Master MND “Shkenca Juridike Civile”. Pas përfundimit të studimeve, ka fituar titullin “Avokat”, titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe licensë Ndërmjetësimi.

Znj. Petriti, ka eksperiencë 15 vjecare në administratën publike, duke mbajtur pozicione të ndryshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si Specialiste, Përgjegjëse sektori në Sektorin e Cështjeve Jo-tatimore pranë Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, si dhe Përgjegjëse sektori në Sektorin e Rekrutimit dhe Promovimit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në vitin 2020, kur është emëruar Shefe Sektori i Administrimit të Prokurimeve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe më tej është ngritur në detyrë, në pozicionin Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Aktualisht, nga marsi 2023 e në vijim, mban pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Z. Luan Dibra, ka ndjekur studimet në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës dhe në vitin 2006 është diplomuar duke marrë titullin “Jurist”.

Z. Dibra ka fituar titullin Avokat në vitin 2007.

Në përvojën e tij profesionale ka punuar si avokat, jurist në institucione të ndryshme. Gjithashtu, ka ushtruar funksionin e Këshilltarit të Kabinetit pranë Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku ka ushtruar përkohësisht dhe funksionet e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Aktualisht, nga shkurti 2023, mban pozicionin e Këshilltarit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Dorina Prifti, ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër, në periudhën 2001-2005.

Znj. Prifti, ka një eksperiencë prej gati 15 vitesh, fillimisht si sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Dhomën Penale, si dhe Dhomën Civile, në Seksionin Administrativ.

Prej vitit 2014 ka punuar pranë Gjykatës së Lartë dhe prej shkurtit të vitit 2019 ka qenë pjesë e administratës mbështetëse për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Aktualisht, nga korriku 2023, mban pozicionin e Këshilltarit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Afërdita Deda, pas Masterit (MND) në Fakultetin e Drejtësisë, ka punuar fillimisht si jurist në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, e më pas është angazhuar në

Organizata Jofitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare (UNICEF, CRCA, QSHPLI), gjithmonë në mbrojtje të të drejtave të njeriut e sidomos të fëmijëve.

Ndërkohë, znj. Deda ka zhvilluar kërkim shkencor për marrjen e gradës Shkencore “Doktor” të cilën e mbrojtë me vlerësimin maksimal.

Prej gati 10 vitesh ka punuar në Shoqëritë Huamarrëse në Administrim (Ministria e Financave), ku si jurist ka përfaqësuar interesat e institucionit në gjykatë dhe organe të tjera.

Aktualisht, nga nëntori 2022, mban pozicionin e Këshilltarit të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Teuta Nuredin, ka përfunduar në vitin 2006 studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Znj. Nuredin ka një eksperiencë 16 vjecare në profesionin e juristes. Karrierën e ka nisur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një periudhë 8 vjecare. Më pas ka filluar punë në Gjykatën e Lartë, ku ka punuar si pjesë e administratës në sektorë të ndryshëm. Për një periudhë 1 vjecare ka qenë Përgjegjëse pranë Sektorit të Administrimit Gjyqësor, më pas atë të Regjistrimit të Cështjeve, si dhe Kryesekretare pranë Gjykatë së Lartë.

Aktualisht, nga dhjetori 2023 e në vijim, mban pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Z. Marvin Agalliu, ka përfunduar studimet e larta universitare, në Fakultetin Ekonomik, Universiteti Tiranës në Financë, si dhe ciklin e dytë të studimeve në Master Shkencor “Administrim Biznes”.

Z. Agalliu ka ushtruar veprimtari profesionale, si specialist Financiar-Kontabilist, në Departamentin Financë-Kontabilitet, në bankën Credins, inspektor në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, menaxher në Shoqërinë “Teuta Durrës” shpk, si dhe Drejtor Marketingu në kompaninë “GIOAD” shpk.

Aktualisht, nga janari 2021 e në vijim, mban pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Investimeve dhe Planifikimit Strategjik, në Departamentin e Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Rezarta Taushani, ka përfunduar studimet e larta në vitin 2007, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, më pas ka ndjekur studimet në Master Profesional “E drejtë Penale”.

Znj. Taushani ka një eksperiencë të gjatë në pozicione si Kancelare në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Vlorë, Kryesekretare, Sekretare gjyqësore dhe juriste.

Gjithashtu, ka kryer një sërë kualifikimesh dhe trajnime, nga institucione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, duke disponuar çertifikata dhe dëshmi të ndryshme trajnimi dhe kualifikimi.

Aktualisht, nga korriku 2020, mban pozicionin e Këshilltarit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Gentiana Agushi, ka përfunduar studimet e larta në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 1995. Në vitin 2000 ka fituar titullin “Avokat”. Dhe më pas është licensuar si Ndërmjetëse nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

Znj. Agushi e ka nisur përvojën profesionale si jurist në Komisionin e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, në Bashkinë Tiranë, më pas ka vijuar si Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Njësinë Administrative nr.7, Bashkia Tiranë. Gjithashtu ka mbajtur pozicionin e Shefit të Sektorit në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

Prej viti 2015-2019 ka ushtruar funksionin e Inspektorit pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Znj. Agushi ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme me tema “mbi reformën në administratën publike dhe aftësitë menaxhuese”, “etika dhe antikorrupsioni” etj.

Aktualisht, nga tetori 2019, mban pozicionin e Këshilltarit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Vjollca Kola, ka përfunduar studimet e larta në Shkenca Ekonomike dhe Shkenca Juridike, më pas ka përfunduar studimet në Master Shkencor në “E drejtë Civile dhe Tregtare” dhe Master Profesional në “E drejtë Penale”.

Znj. Kola ka mbajtur pozicionin e sekretares dhe kryesekretares prej vitit 2000 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Në mars 2014 ka ndjekur dhe përfunduar trajnimin “Mekanizmat e Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri”, realizuar nga ekspertë të “Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve” dhe Qendra “Fëmijët sot”.

Në prill 2015 ka përfunduar programin e trajnimit fillestar profesional për ndërmjetës.

Aktualisht, nga tetori 2019, mban pozicionin e Këshilltarit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Znj. Anisa Brano, ka përfunduar studimet e larta në Drejtësi dhe Shkenca Politike. Në vitin 2016 ka fituar titullin “Avokat”.

Znj. Brano ka ushtruar funksione si Koordinatore e klubeve studentore, Përgjegjëse e Zyrës Alumni dhe Karriera, Asistent lektore, Koordinatore aktivitetesh në Universitetin Marin Barleti.

Nga marsi 2017 deri më korrik 2018 ka ushtruar funksionin e Përgjegjëses se Zyrës Rajonale Tiranë pranë (ZVRPP) tek ADISA.

Znj. Brano, ka kryer një sërë kualifikimesh dhe trajnime, nga institucione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, duke disponuar çertifikata dhe dëshmi të ndryshme trajnimi dhe kualifikimi.

Aktualisht, nga tetori 2019, mban pozicionin e Këshilltarit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.